

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr.4288, datë 30.4.2010

**PËR KONTROLLIN CILËSOR DHE SASIOR TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS
DHE LËNDËVE DJEGËSE TË LËNGSHME, TË GATSHME PËR TREGTIM, TË
PRODHUARA NË RAFINERINË E NAFTËS DHE NË IMPIANTET E PRODHIMIT TË
LËNDËVE DJEGËSE TË LËNGSHME NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 22 dhe 24 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, të ligjit nr.9595, datë 27.7.2006 “Për krijimin e Inspektoratit Qendror Teknik”, dhe të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe udhëzimit nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat”, i ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Kontrolli cilësor dhe sasior i nënprodukteve të naftës dhe i lëndëve djegëse të lëngshme të gatshme për tregtim, të prodhuara në rafineritë e naftës dhe në impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme në Republikën e Shqipërisë, realizohet nga Inspektorati Qendror Teknik (IQT), në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe nga strukturat përgjegjëse të organeve tatimore në varësi të Ministrisë së Financave.

2. Ndalohet tregtimi i nënprodukteve të naftës dhe i lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, të prodhuara në rafineritë e naftës dhe në impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, të cilat janë të pacertifikuara për cilësinë e tyre nga IQT dhe janë të pamonitoruara nga ana sasiore prej organeve tatimore.

3. Rafineritë e naftës dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme janë të detyruara të deklarojnë paraprakisht në strukturat përgjegjëse të IQT-së dhe të organeve tatimore:

a) Llojet e nënprodukteve të naftës dhe të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, që janë të mundshme për t’u prodhuar në këto rafineri naftë ose në impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme.

b) Rezervuarët që do të përdoren për depozitimin e nënprodukteve të naftës dhe të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, të specifikuara sipas emërimit të projektit, llojit të produktit që depoziton dhe kapacitetit mbajtës të tyre.

4. Nuk lejohet depozitimi i nënprodukteve të naftës dhe të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, në rezervuarë të tjerë të cilët janë të padeklaruara në IQT dhe në organet tatimore.

Në rast të mosrespektimit të kësaj pike, organet tatimore zbatojnë penaltitetet e nenit 40 dhe 41 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Rafineritë e naftës dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, në hyrje dhe dalje të çdo rezervuari të produkteve të gatshme për tregtim, të vendosin dhe të mbajnë përherë në funksion, aparate matës sasie të kontrolluara dhe certifikuara më parë nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë i plumbos këto aparate, duke mbajtur për secilën dokumentacionin përkatës.

6. Furnizimi për depozitim i nënprodukteve të naftës dhe të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, nga rafineritë e naftës dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, për në rezervuarët e tregtimit me nënprodukte të gatshme, të bëhet në prani të organeve fiskale dhe IQT, të cilat paraqiten me njoftimin e subjektit.

7. Organet fiskale dhe të Inspektoratit Qendror Teknik kontrollojnë përfundimin e

furnizimit dhe depozitimit të secilit rezervuar me nënprodukte të gatshme nga rafineritë dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, dhe në prezencë të përfaqësuesve të këtyre subjekteve mbyllin saraçineskat e hyrjes dhe daljes së tyre, duke i plumbosur ato.

8. Inspektorati Qendror Teknik me njoftimin nga rafineritë e naftës dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, në zbatim të procedurave ligjore dhe teknike, në prani të përfaqësuesit dhe subjektit, realizon marrjen e mostrës të nënproduktit të gatshëm të naftës ose të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, pasi ka verifikuar më parë dokumentacionin për furnizimin e rezervuarit dhe gjendjen teknike të tij.

Inspektorati Qendror Teknik kryen analizat për të vlerësuar standardin e cilësisë së nënprodukteve të naftës ose të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, dhe lëshon certifikatën përkatëse për cilësinë. Koha e kryerjes së analizave dhe e lëshimit të certifikatës, nuk mund të jetë më shumë se një ditë nga njoftimi që ka bërë subjekti.

9. Rafineritë e naftës dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme e realizojnë tregtimin e produktit të gatshëm vetëm pas lëshimit të certifikatës nga ana e Inspektoratit Qendror Teknik dhe heqjes së plumbosjes së vendosur më parë nga organet përkatëse.

10. Për çdo rast shitjeje të nënprodukteve të naftës ose të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, nga ana e rafinerive dhe impianteve të prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, plotësohet dokumentacioni, faturë tatimore, certifikatë origjine, certifikatë cilësie, duke e shoqëruar edhe me mostër përfaqësuese të nënproduktit që tregtohet.

11. Rafineritë e naftës dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, të krijojnë kushtet optimale për realizimin e kontroleve nga ana e strukturave shtetërore tatimore dhe të Inspektoratit Qendror Teknik.

12. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, organet tatimore dhe Inspektorati Qendror Teknik të caktojnë përfaqësuesit e tyre të autorizuar pranë rafinerive të naftës dhe impianteve të prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, të cilat duhet të krijojnë kushtet e nevojshme me ambiente pune, për të lehtësuar procedurat e kontrollit sasior dhe të certifikimit cilësor të nënprodukteve të gatshme për tregtim.

13. Në rast shkelje të kërkesave të këtij urdhri, zbatohen sanksionet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për veprimtarinë përkatëse.

Ky urdhër hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS
Dritan Prifti

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode